



INSTITUTE FOR DEVELOPMENT POLICY  
INSTITUTI PËR POLITIKA ZHVILLIMORE



**RA  
PO  
RTI**

**VJE  
TOR**

2  
0  
1  
8

# TABELA E PËRMBAJTJES

## **PËR NE**

---

*Faqe 4 — 5*

## **01**

---

### **QEVERISJA DEMOKRATIKE**

---

*Faqe 6 — 17*

## **02**

---

### **ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM**

---

*Faqe 18 — 29*

## **03**

---

### **BASHKËPUNIMI RAJONAL**

---

*Faqe 30 — 31*

# PËR NE

INSTITUTE FOR DEVELOPMENT POLICY  
INSTITUTI PËR POLITIKA ZHVILLIMORE

## Pse jemi këtu

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) është themeluar në vitin 2011 për të vendosur një shtet demokratik, të bazuar në parimet e zhvillimit të

## Çfarë jemi

INDEP në thelb është një think tank me një fokus të veçantë në avokim në nivelet legjislative lokale dhe qendrore. Puna jonë fokusohet në zhvillimin e analizave të politikave dhe ligjeve, dhe avokimin për të siguruar që politikat dhe legjislacioni vendor të jenë të hapura, demokratike dhe të

## Si e arrijmë suksesin

### Qeverisja Demokratike

Nëpërmjet programit tonë të Qeverisjes Demokratike ne synojmë që të ndihmojmë në zhvillimin e politikave të suksesshme afatgjata. Në këtë program, ne punojmë drejtpërdrejtë me vendimmarrës në ekzekutiv dhe legjislativ për analizë, debatim dhe implementim të politikave shtetërore. Ne synojmë që ti arrijmë këto parime nëpërmjet proceseve demokratike me përfshirje të gjerë të publikut.

### Zhvillimi i Qëndrueshëm

Nëpërmjet programit të Zhvillimit të Qëndrueshëm, ne synojmë që të gjitha aktivitetet tona të ekzekutohen nëpërmjet prizmit të zhvillimit të qëndrueshëm. Ky program ka fokus të veçantë në zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme, si një nevojë kyçe për Kosovën dhe përgjegjësinë tonë ndaj planetit. Në këtë program gjithashtu përfshihen zhvillimi i politikave

### Bashkëpunimi Rajonal

Nëpërmjet programit të bashkimit rajonal ne synojmë që të gjitha aktivitetet tona, dhe politikat e shtetit të Kosovës ti rrjetëzojmë në kontekst të rajonit. Përveç shumëfishimit të efektit të punës tonë, kjo gjithashtu na mundëson zhvillimin e marrëdhënieve fqinjësore, të cilat për zhvillim të qëndrueshëm demokratik,

# QE VE RI SJA

# DE MO KRA TI KE



## 100 ditëshi i qeverisë Haradinaj

Programi i qeverisjes demokratike, kërkon vlerësimin e politikave të ekzekutivit dhe ato të legjislativit. Si pjesë e këtij angazhimi, ne kemi analizuar 100 ditëshin e parë të qeverisë së re në vitin 2018.

Së bashku me Grupin për Studime Politike dhe Juridike dhe Institutin GAP analiza jonë ka shqyrtuar:

- Vendimet e marra dhe përmbajtjen e tyre;
- Programin legjislativ, projektligjet e hartuara, të miratuara dhe nismat e reja legjislative;
- Zhvillimet dhe sfidat kryesore të diplomacisë Kosovare;
- Njohjet e pavarësisë dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare

Ne kemi identifikuar mos-publikimin e dokumenteve zyrtare, që transparencën publike. Kjo e fundit është tejet e rëndësishme për qeverisjen demokratike dhe si një nga shtyllat të avokimit për INDEP gjatë 2018.

## Investometri

Në 2018, INDEP ka zgjeruar webfaqe e cila për monitorimin e shpenzimeve kapitale në Kosovë, INVESTOMETRI në të tërë 38 komunat e Kosovës.

Qeverisa demokratike ngërthen në vete zhvillimin e politikave të shpenzimit të fondeve publike në dobi të qytetarëve.

Për këtë arsye, INDEP e sheh të nevojshëm monitorimin e vazhdueshëm të zhvillimit të politikave investuese si dhe efektivitetin e implementimit të këtyre politikave

Investometri:

- Ndhmon në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve;
- Monitoron premtimet zgjedhore të partive politike;
- Rrit transparencën e mbikëqyrjes të shpenzimit të buxhetit;
- Rrit bashkëpunimin e komunave me qytetarët e tyre;

## Vendimmarrja demo- kratike e informuar

Në INDEP ne besojmë që qeverisja demokratike e suksesshme bëhet vetëm me pjesëmarrjen e vazhdueshme të hisedarëve të ndryshëm, duke përfshirë qytetarët, OSHC-të dhe ekspertët e pavarur.

Në vazhdimësi të projektit për promovimin dhe inkurajim të bashkëpunimit në mes të hisedarëve si mjet për instalimin e praktikës demokratike në vendimmarrje, INDEP ka punuar me Komisione Parlamentare dhe hisedarë për të përmirësuar politikën.

Nëpërmjet këtij projekti, INDEP në bashkëpunim me Kuvendin e Kosovës u ka ofruar qasje të drejtpërdrejtë në ligj-bërje dhe politik-bërje grupeve të OSHC-ve dhe grupeve të margjinalizuara ndaj ligjeve që i ndikojnë.

INDEP gjithashtu ka ndihmuar ligjëbërësit me 13 hulumtime dhe analiza për të siguruar ligj-bërje të pavarur dhe të informuar sa i përket zhvillimit të vendit.

## Monitorimi i standardeve

Qeverisja demokratike kërkon monitorim të vazhdueshëm dhe asistencë ndaj institucioneve politik bërëse.

Ne jemi angazhuar në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Divizioni i Turizmit, Divizioni i Infrastrukturës së Cilësisë/ Departamenti i Industrisë dhe Departamenti Ligjor.

Si pjesë e përkushtimit tonë, ne kemi bere analiza dhe hulumtime për:

- Koncept Dokumentin për Turizmin
- Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Zonat Ekonomike
- Rregullorja për Përmbajtjen dhe Mënyrën e Menaxhimit të Regjistrimit të Rregullave Teknike, Trupave të Emëruar për Vlerësimin e Konformitetit, Dokumenteve të Huaja dhe Shenjave të Konformitetit

## Vendimmarrja demo- kratike e informuar

Angazhimi i sigurtë i politik bërësve dhe shërbyesve civil është i domosdoshëm për të siguruar qeverisje të mirëfilltë demokratike.

Për këtë arsye, punësimi i shërbyesve civil sipas meritokracisë, dhe komunikimi më i mirë me qytetarë ka qenë një nga fokuset e rëndësishme të punës tonë në 2018.

Gjatë 2018, INDEP, në sajë të platformës WeBER, ka monitoruar reformën e administratës publike në komunat e Drenasit dhe Obiliqit.

Në bazë të anketave me shërbyes civil dhe dialogut me organizata jo-qeveritare dhe qytetarë në këto komuna, INDEP ka publikuar dy raporte të hulumtimit rreth punëdhënies meritokratike dhe llogaridhënies lokale.

Bashkëpunimi me organizata qeveritare, shoqëri civile dhe qytetarë mbetet një aspekt rrënjësor i punës tonë.



## 100 Ditë Qeveri Haradinaj


Në fillim të vitit ne u angazhuam me analizën e 100 Ditëshit të Parë të Qeverisë Haradinaj. Ky punim është përpiluar në partneritet me dy organizata të tjera joqeveritare lokale, Grupin për Studime Juridike e Politike (GSJP) dhe Institutin GAP. Punimi vlerësoi katër shtylla kryesore.

Shtylla e parë analizoi vendimet e marra dhe përmbajtjen e tyre.

Shtylla e dytë vlerësoi në detaje programin legjislativ, më saktësisht projektligjet e hartuara, të miratuara dhe nismat e reja legjislative.

Shtylla e tretë dhe e katërt pasqyronin zhvillimet dhe sfidat kryesore të diplomacisë Kosovare, duke u fokusuar në njohjet e pavarësisë së Kosovës dhe anëtarësimin e saj në organizata të ndryshme ndërkombëtare si dhe nivelin e arritur të transparencës që Qeveria ka reflektuar gjatë 100 ditëshit të qeverisjes.

Përpos këtyre, atë që kjo analizë arriti të konstatojë ishte që Qeveria Haradinaj nuk ka ndërmarrë hapa gjatë 100 ditëve të para të saj për të publikuar dokumentet zyrtare siç janë kontrata për homologim të automjeteve, kontratat për ndërtimin e autostradave dhe, ndër të tjera, listat e bizneseve të cilat kanë përfituar nga falja e borxheve, zhvillime këto që dëmtojnë rëndë nivelin e transparencës dhe llogaridhënies së Qeverisë Haradinaj.



## Investometri

Mungesa e transparencës dhe aftësive monitoruese rreth shpenzimit të buxheteve komunale të investimeve kapitale na ka shtyrë të zhvillojmë INVESTOMETRI. Ky mjet, ka për qëllim të vlerësojë progresin dhe suksesin e investimeve kapitale në tetë komuna të përzgjedhura.

Komuna e Prishtinës, Fushë Kosovës, Obiliqit, Drenasit, Gjilanit, Novobërdës, Kamenicës dhe Graçanicës janë përfituesit e drejtpërdrejtë të këtij projekti, i cili është hartuar me qëllimin e vetëm për të promovuar praktika transparente në menaxhimin e investimeve kapitale në nivel lokal. Platforma ofron informacion për qytetarët lidhur me ku dhe si shpenzohen buxhetet komunale dhe kur ata duhet të presin ta shohin përfundimin e tyre. Gjithashtu, platforma shërben si një mjet që do të

tregojë efektivitetin e subjekteve partiake në drejtim të menaxhimit të suksesshëm të komunave që ata udhëheqin, si dhe, në mënyrë të ngjashme, të nivelit të përgjegjësisë të treguar nga këto subjekte politike ndaj zonave të tyre zgjedhore.

Si pjesë e këtij projekti, ne punojmë ngushtë me grupet e qytetarëve dhe OJQ-të lokale për t'i mobilizuar ata për angazhim aktiv në hartimin e buxhetit publik dhe menaxhimin efektiv. Përveç kësaj, ne punojmë ngushtë me strukturat komunale për të kuptuar nevojat dhe sfidat e tyre në drejtim të sigurimit të një pjesëmarrjeje më aktive të qytetarëve në nivelet e krijimit të politikave lokale.

Projekt tre vjeçar nga INDEP-i, këtë vit INVESTOMETRI u zgjerua në 38-të komunat e Kosovës.

Stafi i INDEP-it organizoi takime me përfaqësuesit e komunave përkatëse dhe qytetarët për të identifikuar shqetësimet e tyre në lidhje me investimet kapitale. Në këto takime INDEP fitoi besimin e qytetarëve që të përdorin këtë platformë në mënyrë që të jenë të informuar mbi investimet kapitale në komunat e tyre dhe të jenë monitorues të vendimeve nga autoritetet lokale ndaj investimeve kapitale,

Pas përfundimit të projektit, falë bashkëpunimit të sinqertë e të mirëfilltë me komunat platforma është e paraparë të kalojë në menaxhim të tyre.

# QEVERISJA

# DEMOKRATIKE



Analiza e Raportit Vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave	Rishikimi i Agjencive të Pavarura me qëllim racionalizimin e funksioneve dhe ngritjen e performancës
Analiza e Raportit Vjetor të Komisionit për Miniera dhe Minerale	Reformë Rrënjësore Në Numrin, Funksionin Dhe Llogaridhënien e Agjencive Të Pavarura
Analiza e Raportit Vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit	Funksionalizimi i Punës Së Agjencive Të Pavarura, Sfidat Dhe Rruga Përpara
Analiza e Raportit Vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji	Rregullimi ligjor i Agjencive të Pavarura
Analiza e Raportit Vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil	Monitorimi i Zbatimit të Ligjeve
Analizë e Projektligjit Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje	
Projektligji për Masa Mbrojtëse në Import	
Projektligji për Produkte të Ndërtimit	

## Monitorimi i standardeve

Qëllimi kryesor i projektit në fjalë ishte pasqyrimi i nivelit të zbatimit të standardeve minimale në proceset e konsultimit publik nga institucionet qendrore të Republikës së Kosovës. Institucioni i cili u monitorua nga INDEP ishte Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), përkatësisht Divizioni i Turizmit, Divizioni i Infrastrukturës së Cilësisë/Departamenti i Industrisë dhe Departamenti Ligjor. Me anë të këtij projekti, u mbajtën takime të shpeshta me përfaqësues të ministrisë në fjalë.

Dokumentet në të cilat u dha kontributi i INDEP-it janë koncept dokumenti mbi turizmin, Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Zonat Ekonomike, dhe Rregullorja për Përbajtjen dhe Mënyrën e Menaxhimit të Regjistrimit të Rregullave Teknike, Trupave të Emëruar për

Vlerësimin e Konformitetit, Dokumenteve të Huaja dhe Shenjave të Konformitetit. Rezultat i kënaqshëm i këtij projekti ishte miratimi i koncept dokumentit për turizëm, në të cilin u përfshinë komentet tona të dhëna gjatë procesit konsultativ. Ky dokument në të ardhmen do t'i hapë rrugë mundësisë që të hartohet një bazë ligjore që do të shërbejë për përmirësimin e zinxhirit të funksionimit të institucioneve dhe politikave në drejtim të promovimit dhe rritjes së turizmit në vend. Sa i përket dy proceseve tjera konsultative, edhe ato gjithashtu rezultuan të suksesshme me krijimin e partneriteteve të reja e të frytshme për të ardhmen me divizionet e departamentet përkatëse.

## Vendimmarrja demokratike e informuar

INDEP është fokusuar në rritjen e kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse për krijim të politikave në nivel qendror. Ne e kemi bërë këtë duke u ofruar atyre mbështetje të pavarur hulumtuese me qëllim që të sigurojnë vendime të informuara politike.

Në këtë drejtim, INDEP angazhohet drejt sigurimit të hapësirës për qasje të drejtpërdrejtë të palëve të interesuara dhe të marginalizuara. Rrjedhimisht, zbatimi i aktiviteteve të parashikuara jo vetëm që pritet të kontribuojë në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në hartimin e politikave, mirëpo do të kontribuoj po ashtu në mënyrë të barabartë në rritjen e kapaciteteve të vetë stafit organizativ dhe zgjerimin e kapaciteteve të rrjetëzimit dhe shpërndarjes.

Nëpërmjet këtij angazhimi, INDEP ofron ndihmë të rregullt teknike për stafin civil të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Tregti, Infrastrukturë, dhe Zhvillim Rajonal si dhe Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor. Ndihma teknike fokusohet në aspektin e angazhimit në përpilim të politikave dhe legjislacionit të pavarur me qëllim që të krijohen baza të forta për ata që të mos varen në të ardhmen nga ndihma e huaj në këtë drejtim. Përveç kësaj, në këtë proces, INDEP ka punuar ngushtë me OShC-të lokale në drejtim të mobilizimit të tyre për t'u angazhuar më aktivisht në përmbushjen e kriterëve të MSA-së.

Ne arritëm të publikojmë 13 punime, 8 nga të cilat ishin hulumtime parlamentare dhe 5 të tjera analiza të politikave.

Fokusi kryesor ishte në agjencitë e pavarura, funksioni i tyre si dhe analizimi i përmbushjes së standardeve mbi raportet vjetore të përpiluara nga ato. Hulumtimet parlamentare përfshinë edhe analiza të projektligjeve dhe monitorim të zbatimit të ligjeve, të cilat u prezantuan në komisionet parlamentare dhe u cituan shumë herë nga deputetët të cilët janë edhe disa nga partnerët kryesor në projekt.

QE  
VE  
RI  
SJA

120 ANKETA

2 FOKUS GRUPE

2 HULUMTIME

DE  
MO  
KRA  
TI  
KE

## Transparenca dhe llogaridhënia në komunat e Kosovës

Në pjesën e parë të vitit 2017, INDEP implementoi projektin “Përmirësimi i llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve publike përmes një administrate lokale profesionale e të pandikuar politikisht”.

Ky projekt u realizua në kuadër të platformës rajonale Western Balkans Enabling Projects for Civil Society Monitoring of Public Administration Reform (ËeBER), platformë kjo e cila ka për qëllim mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile për të monitoruar reformën e administratës publike dhe zhvillim sa më të qëndrueshëm të saj duke promovuar dialog të mirëfilltë politik dhe raportim kualitativ të mediave. Përfituesit e këtij projekti ishin dy komuna, ajo e Drenasit dhe Obiliqit. Qëllimi kryesor i projektit ishte identifikimi i sfidave kryesore në funksionimin dhe llogaridhënien e administratës lokale, specifikisht në lidhje me shërbimet publike

dhe menaxhimin e burimeve njerëzore.

Në shkurt 2018, nga ky projekt dolën dy hulumtime të cilat theksuan nevojën për zgjerimin e reformave me qëllim të promovimit të meritokracisë në proceset publike rekrutuese dhe rritjes së nivelit të llogaridhënies në administratat lokale. Stafi i INDEP-it ka anketuar gjithsej 120 zyrtarë të administratave lokale në këto dy komuna, si dhe mbajti 2 fokus grupe me organizata jo-qeveritare dhe qytetarë nga këto komuna, në mënyrë që të gjeturat e hulumtimeve të jenë sa më reale.



Kryeprokurori të nisë hetimet ndaj veprimeve të kundërligjshme që po ndodhin në vend

Qeveria Haradinaj ta ndalë praktikën e shkeljes së ligjeve në fuqi 



Reagim ndaj vendimit të qeverisë për emërimin e sekretarit të përgjithshëm të MTI-së

## Reagime

Në INDEP, ne mbetemi të përkushtuar që të arrijmë të sigurojmë që të sigurojmë llogaridhënje ndaj zhvillimeve rreth qeverisjes demokratike.

Për të parandaluar keqpërdorimin e pozitave zyrtare dhe denoncimin e tyre, INDEP në partneritet me OJQ-të lokale i ka kërkuar Kryeprokurorit të Shtetit që të nisë procedurat hetimore ndaj kryeministrit, vartësve të tij apo cilitdo vartës të politikës që mund të keqpërdorë pozitën e tyre me vendime që krijojnë standardin e shkeljeve ligjore të hapura. INDEP i bëri thirrje këtyre dy institucioneve që të dëshmojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre politike, profesionalizmin, dhe pandikueshmërinë politike.

Duke avokuar për respektim të ligjeve dhe anulim të vendimeve jo ligjore, reagimi i

dytë i INDEP-it në bashkëpunim me Institutin GAP dhe GLPS ju adresua Qeverisë Haradinaj. Në këtë reagim INDEP ngriti zërin mbi vendimin për emërimin e dy anëtarëve në bordin e ndërmarrjes publike NPH “Ibër Lepenci” Sh.A., emërimet të bëra në nuanca politike dhe në kundërshtim me Ligjin nr. për Ndërmarrjet Publike. INDEP beson se politizimi i ndërmarrjeve publike dëmton rëndë institucionin dhe procesin e konkursit publik, të drejtën e trajtimit të barabartë të qytetarëve dhe legjislacionin në fuqi.

Përderisa INDEP reagoi për parregullsitë e shumta në emërimet të shërbyesve civil, edhe një rast i tillë ndodhi me emërimin e sekretarit të përgjithshëm të MTI-së, kandidat i cili nuk i plotësonte kriteret për këtë pozitë të lartë. E aq më tepër, komisioni

vlerësues i kësaj pozite ishte i mbështetur nga kompania britanike në përputhje me memorandumin e nënshkruar mes Qeverisë së Kosovës me Ambasadën Britanike në Prishtinë në tetor të 2017-tës. Me këtë vendim, Qeveria e Kosovës ka shkelur ligjin për shërbimin civil, ka politizuar një ndër pozitat më të larta në shërbimin civil, ka sakrifikuar profesionalizmin dhe ka shkelur të drejtat në punësim, si dhe ka shkelur memorandumin e mirëkuptimit me Ambasadën Britanike për rekrutim të profesionistëve në pozita të larta shtetërore.

INDEP, Instituti GAP dhe Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) shprehën shqetësimin e tyre me Qeverinë e Kosovës për mosrespektimin e Memorandumit të Mirëkuptimit me Ambasadën

# QEVERISJA

# DEMOKRATIKE



## Reagime

Britanike dhe për vazhdimin e politizimit të emërimeve në pozitat e larta në Qeveri dhe borde. Reagimi ka kërkuar që këto praktika të ndalen menjëherë dhe të gjitha pozitat për të cilat kompania profesionale britanike ka shprehur kundërshtim të hapur të revokohen. Politizimi në pozita të larta në Qeverinë e Kosovës dhe në bordet e agjencive të pavarura dhe agjencive qeveritare është shndërruar në një problem kronik. Emërimi dhe zgjedhja e anëtarëve politikë dhe jomeritorë në pozita kyçe në institucione dhe agjenci është jo vetëm e kundërligjshme por edhe dëmton rëndë barazinë para ligjit dhe konkurseve publike.

Përpos pakënaqësive me rekrutimet dhe emërimet joprofesionale, drejtori ekzekutiv i INDEP në shenjë proteste ndaj vendimeve të Qeverisë dhe

Kuvendit të Kosovës, të cilët vazhduan të zgjedhin kandidatë të cilët nuk kanë plotësuar kushtet për të mbajtur pozita të caktuara në institucione shtetërore, dhe njëkohësisht duke neglizhuar reagimet e shumta të shoqërisë civile e aq më tepër zbatimin e memorandumeve me Ambasadën Britanike, dha dorëheqje nga të qenit pjesë e komisionit vlerësues për zgjedhjen e Kryeshefit të Agjencisë Kosovare të Efiçencës së Energjisë.

Duke u bazuar në interpretimin e bazës ligjore, statutit, Kodit të Etikës, Rregullores për zgjedhjen e personelit akademik në UP, INDEP bashkë me Institutin Kosovar për Drejtësi (IKD) iu drejtuan organeve të universitetit, në veçanti Këshillit të Etikës, me qëllim që të bëjnë publike masat dhe standardet e shkruara në lidhje me parandalimin e nepotizmit në



**Të ndalet politizimi i shërbimit civil dhe institucioneve të pavarura dhe të respektohet memorandumi me Ambasadën**

**Në shenjë proteste, drejtori ekzekutiv i INDEP dorëhiqet nga komisioni vlerësues për zgjedhjen e kryeshefit të AKEE**



**INDEP dhe IKD i bëjnë thirrje MASHT-it dhe KD-së ta zbatojnë udhëzuesin e standardeve dhe parimeve etike në rekrutimin e stafit të ri akademik në UP**

procesin e rekrutimit të personelit akademik. Këshilli i Etikës në përgjigje të Opinionit të Avokatit të Popullit dhe kërkesës së Instituteve tona, nxori 'Udhëzues për standardet dhe parimet etike të Universitetit të Prishtinës në lidhje me shmangien e nepotizmit dhe parandalimin e konfliktit të interesit në procedurat e zgjedhjes së stafit akademik për pozitat e reja, sipas institucionit të konkursit publik'. Pasi Këshilli i Etikës nxori këtë udhëzues, INDEP dhe IKD përmes një letre drejtuar Ministrit të Arsimit dhe Këshillit Drejtuesit të UP-së, i kanë bërë thirrje ta kenë parasysh këtë udhëzues dhe t'i zbatojnë standardet dhe parimet etike që janë listuar në mënyrë që të luftohet fenomeni i nepotizmit dhe të parandalohet konflikti i interesit në rekrutimin e stafit

akademik të UP-së.

Në vazhden e reagimeve, brenda një periudhe kohore prej vetëm 6 muajsh, INDEP i drejtoi përsëri letër kryeprokurorit. Këtë herë në lidhje me humbjen e shumës prej 53 milionë euro të buxhetit të shtetit si rezultat i mos përmbushjes së detyrimeve të kontratës nga ana e qeverisë së Kosovës. Rasti konkret duhej të shërbente si alarm për Prokurorinë e Republikës së Kosovës për të hetuar mundësinë për një abuzim të parasë publike të përmasave enorme. Mungesa e reagimit të prokurorisë në raste të më hershme, ka krijuar komoditetin e keq menaxhimeve të fondeve publike.

Sa i përket sektorit të energjisë dhe puna e bërë nga

akterët kyç të këtij sektori, INDEP reagoi ndaj ndërprerjeve të paligjshme të furnizimit me energji elektrike. Letra drejtuar Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, ZRRE, thekson se kjo praktikë shkelë Ligjin Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, Ligjin Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit, të drejtat njerëzore të qytetarëve për qasje në shërbime jetike si dhe cenon lirinë ekonomike të subjekteve biznesore. Ndërprerja e energjisë elektrike, sidomos në muajt e ftohtë të dimrit mund të shkaktojë dëme në shëndetin e popullatës, ndërpret ose dobëson shërbimet shëndetësore publike etj. Gjithashtu, përmes ndërprerjeve të paligjshme të energjisë elektrike, KEDS/ KESCO kanë dëmtuar një numër të madh biznesesh të cilat nuk kanë pasur mundësi



# QEVERISJA

# DEMOKRATIKE



## Reagime

të planifikojnë reduktimet.

Nuk ishte kjo letra e vetëm drejtuar ZRRE-së. Në gusht, INDEP reagoi kundrejt vendimit të ZRRE-së për lejimin e humbjeve për KEDS-in i cili veçse dëmtonte qytetarët. Me anë të këtij vendimi ZRRE ka shkelur mandatin për të mbrojtur interesin publik dhe duke përdorur me arbitraritet pushtetin e vet, ka vendosur t'ia faturojë humbjet e një kompanie private, të gjithë qytetarëve të Kosovës. INDEP theksoi se vendimi në fjalë i pa konsultuar dhe i padrejtë do të rrisë fitimet e KEDS dhe do të rrisë varfërinë energjetike të qytetarëve të Kosovës, andaj kemi bërë thirrje që vendimi në fjalë të anulohet dhe njëherazi të bëhet rishikimi i kontratës së shitjes së Distribucionit dhe legjislacionit në fuqi, dhe të sigurohet fuqizimi i një ZRRE-je të pavarur e që punon në interes të publikut, dhe jo të kompanive private.

Në termat e Termocentralit 'Kosova e Re', INDEP, bashkë me organizatat e tjerë pjesë e Konsorciumit Kosovar për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID), gjatë vitit 2018 kategorikisht shprehu qëndrimin e vet për nevojën e menjëhershme të anulimit të kontratës dhe rreziqet që vijnë me ndërtimin e tij. Aq më tepër, ndërtimi i këtij termocentrali do të rrezikonte marrëdhënien e Kosovës me Bashkimin Evropian dhe integrimin e saj në mekanizma ndërkombëtar. Shqetësimi i INDEP forcohet edhe më shumë kur Sekretariati i Komunitetit të Energjisë duke shprehur shqetësim të thellë me kushtet e kontratës, argumenton se nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje rrezikon integrimin dhe marrëdhëniet e Kosovës me Bashkimin Evropian. Andaj, së bashku me KOSID, INDEP-i kërkoi tërheqjen e menjëhershme të këtij projekti të



Letër nga shoqëria civile për kryeprokurorin Aleksandër Lu-mezi

Të ndalen reduktimet e rrymës, të ndëshkohen shkelësit e ligjit dhe të kompensohen qytetarët!



dëmshëm dhe të udhëhiqen politika të sektorit energjetik që drejtojnë Kosovën drejt një zhvillimi të qëndrueshëm.

Në tentativat tona që të mbrojmë mjedisin, INDEP ju bëri thirrje deputetëve të Kuvendit të Kosovës që të mos votojnë ndryshim-plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjete, me arsyetimin se votimi i këtij projektligji do të dëmtoj mjedisin në Kosovë, do të dëmtoj përpjekjet për të përafruar legjislacionin me atë të Bashkimit Evropian dhe do të rrezikoj sigurinë e qytetarëve në komunikacion. Vota kundër këtij projektligji regresiv e të rrezikshëm do t'i hapte rrugë një procesi të mirëfilltë të monitorimit të zbatimit të ligjit në fuqi, që do t'i shërbente përmirësimit të përgjithshëm të tij në interes publik, e jo ndryshimit të pjesshëm të tij për interesa të ngushta.

# ZHVI LLI MI

# QËN DRU E SHË M



## Rockefeller Brothers Fund (RBF)

Në zhvillimin e qëndrueshëm, partneriteti jonë me Rockefeller Brothers Fund gjatë viteve na ka mundësuar që të jemi iniciatori kryesor në vend për politikën e zhvillimit të qëndrueshëm.

Në 2018, në kuadër të bashkëpunimit kemi publikuar:

- 2 Hulumtime Parlamentare për efikasitetin e energjisë dhe KOSTT.
- 7 propozime politikash për mbrojtjen e ambientit dhe burimeve natyrore;
- 3 Analiza rreth të hyrave për ngrohtoret, menaxhimin e mbeturinave dhe planin për termocentralin Kosova e Re;

INDEP mbetet i përkushtuar që të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë. Si të tillë, ne lidhim partneritete me institucione të cilat kanë vizion afat-gjatë dhe që synojnë politika të qëndrueshme

## Edukimi mbi Median dhe Informacionin

Në vitet e fundit, ambienti i medias dhe informacionit ka ndryshuar në mënyrë drastike me proliferimin e burimeve të informacionit online. Si rezultat, edhe INDEP e ka adaptuar platformën e zhvillimit të qëndrueshëm mediatik, duke zgjeruar punën në të gjithë hallkën e konsumit të informacionit, nga gjeneruesit, deri te lexuesit.

Nëpërmjet Edukimit mbi Median dhe Informacion (EMI), INDEP ka bërë një analizë të tërthortë të të gjithë hisedarëve dhe institucioneve të ndërlidhura më leximin kritik, mendimin kritik dhe median e lirë.

Të mbështetur nga UNESCO, ne kemi bërë bashkë Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe akterë të tjerë për të filluar zhvillimin e një kornize për EMI.

Në vazhdim, INDEP do të jetë i ndërlidhur ngushtë me zhvillimet rreth EMI në vend.

## Sistemi Pensional

Zhvillimi i qëndrueshëm gjithashtu kërkon zgjidhje të qëndrueshme për popullatën njerëzore, Një nga këto zgjedhje, ka lidhje të drejtpërdrejtë me sistemin pensional, i cili duhet të sigurojë një jetë të dinjitetshme dhe të qëndrueshme për të gjithë qytetarët.

Në 2018, INDEP ka publikuar 3 studime të cilat ndërlidhen me sistemin pensional në Kosovë.

Në punimin e parë, "Sistemi Pensional në Kosovë: Sfidat dhe Mundësitë" ne kemi identifikuar sfidat dhe mundësitë rreth sistemit pensional në Kosovë.

Në punimin e dytë, "Reforma Pensionale, rruga që duhet ndjekur," ne kemi analizuar hapat hulumtuese dhe vendimmarrëse që duhet marrë.

Në fund, ne kemi dhënë alternativat dhe mundësitë për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme për vendin.

## Prodhimet konkurruese Kosovare

Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik kërkon konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve vendore. Një nga kriteret kyçe të konkurrueshmërisë së produkteve kosovare është sigurimi i standardeve të prodhimit.

Kontributi ynë në këtë sferë është fokusuar në tre aspekte kryesore për të siguruar cilësinë e produkteve vendore:

- Kemi studiuar kërkesat rreth standardeve të cilat lindin nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) me BE-në
- Kemi studiuar se cilat janë target grupet kryesore për bizneset kosovare në tregjet e BE-së
- Kemi evidentuar hapat të cilat bizneset kosovare duhet të ndërmarrin për siguruar përmbushjen e standardeve të cilësisë në fushën e tyre të prodhimit apo shërbimit.

## Qendra Burimore për OShC

Një shoqëri e shëndoshë, kërkon pjesëmarrjen e qëndrueshme dhe të vazhdueshme të qytetarëve në vendimmarrje. Si pjesë e punës sonë për zhvillim të qëndrueshëm, këtë vit ne jemi angazhuar në sigurimin e qëndrueshmërisë së OShC-ve.

Nëpërmjet këtij angazhimi ne kemi:

- Hapur Qendrën e Resurseve për OShC e cila ofron burime të informatave për OShC, mundësi për zhvillim organizativ si dhe hapësirë për përdorim pa obligime buxhetore.
- Filluar Akademinë për Qëndrueshmëri e cila synon të trajtojë në mënyrë të vazhdueshme OShC-të
- Ofruar Grante për OShC-të pjesëmarrëse, të cilat u janë ofruar 15 organizatave lokale që në të ardhmen pritet të punojnë së bashku.

# ZHVI LLI MI I QËN DRU E SHË M



## Zhvillimi i Qëndrueshëm

Për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror e mjedisor, INDEP publikoi nga 10 masa të cilat institucionet qendrore dhe lokale do të mund të implementonin në afat të shkurtër. Përpos tyre, INDEP ishte aktiv edhe me analiza dhe konsultime publike, siç ishte ai për përcaktimin e të hyrave për ngrohtoren e qytetit Termokos Sh.A., në të cilën analizë u propozuan edhe opsione të qëndrueshme të tarifimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

INDEP gjithashtu analizoi kontratën për termocentralin Kosova e Re, duke avokuar për tërheqjen nga marrëveshja për ndërtimin e saj. Për shkak që një investim i këtij lloji do ta binte Kosovën në një kolaps ekonomik, INDEP theksoi se ndalja dhe anulimi i kësaj kontrate janë të domosdoshme për t'i hapur rrugë dialogut të vërtetë shoqëror mbi të ardhmen e sistemit energjetik të Republikës së Kosovës. Krahas kësaj analize, INDEP përpiloi edhe analizën për Projektligjin për

Efiçencë të Energjisë, në të cilën fushë INDEP shtyu draftimin e një legjislacioni që promovon këtë komponent të rëndësishëm në sektorin e energjisë.

Në 2018 është inauguruar Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë, i cili është një hap kyç drejt arritjes së caqeve kombëtare për efiçencë të energjisë. INDEP gjithmonë është pozicionuar si një think tank për zhvillimin e qëndrueshëm si konceptin kryesor për zhvillimin afatgjatë të vendit. Avokimi për themelimin e një Fondi të tillë ka qenë një prej shtyllave kryesore të punës tonë. Themelimi i këtij fondi na gëzon dhe na bën më optimist për sa i përket përkushtimit kombëtar për avancimin e agjendës së Efiçencës së Energjisë në vend.

Përkushtimi ynë në këtë drejtim ka filluar në vitin 2012 kur edhe e kemi konsoliduar bashkëpunimin tonë me Kuvendin e Kosovës, posaçërisht Komitetin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri (CEDITI). Si pjesë e këtij bashkëpunimi, ne kemi mbështetur

Analiza e për të Hyrat të Lejuara për Ngrohtoren e Qytetit Termokos Sh.A.

Menaxhimi i Mbeturave Në Kosovë – Identifikimi i Sfidave të Sektorit

Analizë e Projektligjit për Efiçencë të Energjisë

Analizë e Kontratës TC Kosova e Re

Analiza e Raportit Vjetor të KOSTT

Dita Ndërkombëtare e Tokës: 10 Propozime Politikash drejt Ruajtjes së Burimeve Tokësore

Dita ndërkombëtare e Efiçencës së Energjisë: 10 masa për rritjen e efiçencës së energjisë

Dita Ndërkombëtare e Konservimit të Energjisë: 10 Rekomandime Për Ndryshim Politikash

10 masa që Kosova duhet të ndër marrë për të shënuar ditën ndërkombëtare të pyjeve

10 rekomandimet për shfrytëzim më racional të energjisë

10 Masa të për të Adresuar Problemin e Ndotjes së Ajrit

10 Masat për Mbrojtjen e Mjedisit

komitetin drejt hartimit dhe miratimit të politikave efikase, të qëndrueshme dhe transparente të zhvillimit të cilat rrjedhin nga proceset demokratike. Ne kemi qenë pjesë e grupeve punuese për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit si dhe planeve të ndryshme kombëtare të veprimit. Në mes tjerash, ne ishim pjesë e grupeve të punës për ndryshimin e Ligjit për Efiçencën e Energjisë kur edhe kemi ofruar rekomandimet tona dhe kemi mbështetur përfshirjen e gjetjeve nga monitorimi ynë i Ligjit për Efiçencën e Energjisë të realizuar në vitin 2012. Për shkak të kontributit tonë në këtë grup pune, INDEP u bë pjesë e grupit punues për të hartuar ligjin e ri të Kosovës për Performancën e Energjisë në Ndërtesa.

INDEP ka realizuar një seri publikimesh për Efiçencë të Energjisë. Publikimin e parë e kemi realizuar në vitin 2012 të titulluar 'Efiçencia e energjisë në

Kosovë: Analizë e kornizës ligjore dhe zbatueshmërisë së saj', i cili u pasua nga 'Efiçencia për Zhvillim: Ekonomiksi i Efiçencës së Energjisë në Kosovë', si dhe 'Analizë e Projektligjit për Efiçencën e Energjisë'. Në vitin 2017 ne i ofruam Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik një model të zhvillimit të Fondit të Efiçencës së Energjisë me punimin 'Financimi i Efiçencës së Energjisë – benefitet dhe barrierat'.

Si rezultat i kësaj pune, INDEP është tashmë pjesë e grupit të ri punues për përpilimin e Planit të Tretë Kombëtar të Veprimit për Efiçencë të Energjisë. Përveç avokimit dhe punës tonë në nivel qendror, ne gjithashtu kemi punuar në fushata ndërgjegjësimi dhe kemi implementuar projekte për të informuar qytetarët dhe bizneset rreth rëndësisë së efiçencës së energjisë. Përmes projektit "Mbështetje në implementim të masave të Efiçencës së Energjisë

dhe ngritje të kapaciteteve në sektorin privat dhe atë publik" ne kemi dizajnuar një skemë të granteve për biznese të vogla dhe të mesme për investime të vogla në implementim të masave të efiçencës së energjisë.

Ne kemi sensibilizuar bizneset rreth përfitimit nga investimet e vogla në masat e Efiçencës së Energjisë. Për më tepër, këto grante ishin edhe një prej mënyrave tona për të apeluar tek Qeveria e Kosovës që të shqyrtojë seriozisht themelimin e Fondit për Efiçencë të Energjisë.

Efiçencia e Energjisë zyrtarisht konsiderohet si një burim në vete i energjisë. Me adoptimin e masave të Efiçencës së Energjisë, ne zvogëlojmë kërkesën për energji dhe si përfundim luftojmë varshmërinë tonë nga lëndët fosile dhe gjenerojmë energji e cila është miqësore ndaj mjedisit në të cilin jetojmë.

ZHVI  
LLI  
MIQËN  
DRU  
E  
SHË  
M

## Edukimi mbi Median dhe Informacionin

EMI është projekti i parë i këtij lloji në Kosovë, i mbështetur nga UNESCO. Qëllim kryesor është rritja e kërkesës për media kualitative dhe informacion të besueshëm. Kjo do të arrihet përmes integritit të Edukimit mbi Median dhe Informacionin në politikat publike, që do të shtrojë rrugën për një kornizë të duhur të EMI. INDEP vlerësoi gjendjen e EMI në Kosovë, dhe promovoi mekanizma strategjik dhe politik për EMI. Partnerët kryesor të kësaj iniciative ishin Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë, dhe Zyra e Qeverisjes së Mirë.

INDEP realizoi dy konferenca të cilat në total mblodhën 60 individë të kyçur direkt në temën mbi EMI-në. Në mënyrë që të edukohet një numër më i madh i publikut, INDEP lansoi kampanjën vetëdijesuese për EMI, ku shpërndamë fakte për

EMI në faqen zyrtare 'MIL Clicks in Albanian' në Facebook dhe Twitter.

Pas përfundimit të suksesshëm të konsultimeve nacionale mbi median dhe informacionin në Kosovë, të mbështetur nga UNESCO dhe BE, INDEP ka pranuar me kënaqësi ftesën e UNESCO-s për të qenë pjesë e komitetit drejtues të Koalicionit të Përdoruesve të Medias dhe Informacionit në Evropën Juglindore – CIMU SEE.

Iniciativa e nisur në 2018 do të vazhdojë gjithashtu edhe në vitin 2019, me aktivitete të tjera të cilat do të promovojnë akoma më shumë EMI-n. Qëllimi kryesor në vitin e ardhshëm do të jetë futja e EMI-të në kurrikulat universitare në Degën e Gazetarisë.

7 Fokus Grupe

2 Tryeza

2 Takime

1 Punëtori

## Sistemi Pensional

Gjatë vitit 2018, INDEP arriti të avokojë edhe mbi çështjen e sistemit pensional dhe nevojën e tij për reformim. Projekti me anë të aktiviteteve të implementuara ka synuar identifikimin e sfidave me të cilat ky sistem ballafaqohet si dhe mundësitë që ai ka në të ardhmen.

Nga projekti në fjalë u publikuan tri punime, 'Sistemi pensional në Kosovë: Sfidat dhe mundësitë', 'Reforma Pensionale: Rruga që duhet ndjekur', dhe 'Reforma Pensionale: Alternativat nuk mungojnë, cila është e duhura'. Në kuadër të projektit u organizuan dy tryeza të rrumbullakëta diskutuese, tri takime të mbyllura me përfaqësues të institucioneve kyçe mbi çështjen e pensioneve, një punëtori dhe shtatë fokus grupe të mbajtura

në shtatë komunitet me të mëdha të Kosovës, të cilat gjithsej përfshijn rreth 230 persona që kontribuuan me pikëpamjet dhe rekomandimet e tyre në mundësitë e reformimit të sistemit pensional.

Me përfshirjen e organizatës tonë në temën e skemave pensionale dhe kontributin e dhënë me anë të hulumtimeve të përgatitura gjatë vitit paraprak, INDEP u ftua të jetë pjesë e grupit punues nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) për hartimin e Koncept Dokumentit në Fushën e Pensioneve. Më pas INDEP mbështeti punën e grupit punues me pikëpamjet dhe ekspertizën tonë. INDEP, në mbështetje të MPMS-së, organizoi edhe një punëtori në Tiranë, Shqipëri, ku ndër

përfaqësues të institucioneve qendrore publike të cilët morën pjesë ishte edhe Ministri aktual i MPMS.

Projekti u promovua edhe në platformat televizive, konkretisht u mbajtën intervista të cilat elaboronin qëllimin e projektit në përgjithësi, gjendjen faktike të sistemit pensional dhe rekomandimet e INDEP-it se çfarë duhet bërë në të ardhmen në aspektin e reformimit.

# ZHVI LLI MI I QËN DRU E SHË M



## Prodhimet konkurrenente Kosovare

Projekt ky i mbështetur nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), qëllim kryesor kishte përmirësimin e politikave krahas rritjes së interesimit dhe numrit të bizneseve kosovare që të posedojnë standarde evropiane të definuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA). Përmes këtij projekti, specifikisht, INDEP kontribuoi në disa nga prioritetet e identifikuar që kanë të bëjnë me konkurrencën dhe lëvizjen e lirë të mallrave.

Falë një bashkëpunimi të sinqertë e të mirëfilltë me Agjencinë Kosovare të Standardizimit (MTI), INDEP arriti të publikojë tre punime. Punimi i parë 'Standardizimi në Kosovë dhe sfidat për rritjen e kualitetit të produkteve vendore' shtjelloi gjendjen e prodhuesve vendor kundrejt masave të vëna

nga MSA-ja dhe procesit të standardizimit, kushtet e të cilit duhen përmbushur për ta mundësuar integrimin në tregun evropian të mallrave. Hulumtimi, fillimisht, identifikoi prodhuesit vendorë që kanë potencial të eksportojnë në tregun evropian, ndërkohë që i identifikoi edhe target grupet që ekzistojnë në këto tregje ndërkombëtare. Më tutje, ky hulumtim identifikoi sfidat ekzistuese të prodhuesve vendorë në procesin e standardizimit dhe masave që duhet të ndërmerren për përballimin e konkurrencës.

Në punimin e dytë të publikuar në kuadër të këtij projekti, 'Marrëveshja e Stabilizim Asociimit dhe Standardizimi i Produkteve Vendore', u paraqit gjendja aktuale e implementimit të MSA-së në Kosovë dhe analiza krahasuese mes vendeve të rajonit që e kanë kryer

implementimin e MSA-së shumë më herët se Kosova. Ky hulumtim identifikoi masat që i ka ndërmarrë niveli qendror i institucioneve përkatëse për t'i arritur kriteret e vëna nga kjo marrëveshje dhe politikat lehtësuese që janë formësuar për ta përkrahur prodhuesin vendor krahas konkurrencës së tregut evropian. Të gjeturat shërbyen si rekomandime për nivelin qendror të institucioneve në Kosovë se cilat politika mbështetëse duhet ndjekur për t'i ndihmuar prodhuesit vendor përballë konkurrencës së tregut evropian dhe përmbushjes së kërkesave të dala nga procesi i standardizimit.


Ndërkaq, punimi i tretë, 'Udhëzuesi për Shpërndarjen dhe Shitjen e Standardeve Kosovare', kishte për qëllim të

ju shërbente bizneseve në lidhje me procedurat që duhet ndjekur për tu pajisur me standarde.

Gjatë implementimit të projektit, u organizuan dy tryeza të rumbullakëta dhe një konferencë për shtyp e cila morri mbulim mediatik prej 5 medimeve të ndryshme.

Në shënimin e Ditës së Standardeve nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) së bashku me Agjencinë Kosovare të Standardizimit (AKS), INDEP u ftua për një fjalë hyrëse me të cilin rast u shpërndanë materiale promovuese të projektit duke përfshirë këtu edhe punimet e publikuara. Përpos këtyre dy punimeve, gjatë ditës u lansua videoja promovuese 'Me produkte konkurrenente drejt tregut evropian' e cila u shikua nga 10,000 persona në rrjetin

Facebook dhe 150 persona të cilët morën direkt produktin me anë të USB-ve.



# ZHVI LLI MI I QËN DRU E SHË M



## Java e parë e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Të frymëzuar nga Java Evropian për Zhvillim të Qëndrueshëm një grup aktorësh lokal në Kosovë kemi organizuar Javën e Parë të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kosovës (KSDË). KSDË'18 ishte një ngjarje 5 ditore e cila u fokusua në eksplorimin e sukseseve dhe sfidave kryesore të Kosovës në lidhje me zbatimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Kjo ishte edhe ngjarja e parë e këtij lloji që sjell së bashku Qeverinë e Kosovës, përfaqësuesit e Shoqërisë Civile, komunitetin e donatorëve, ekspertët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, dhe akademinë për të adresuar çështjet që lidhen me qëndrueshmërinë zhvillimi në vend.

Nikoqir i kësaj ngjarje ishte Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë /

Përfaqësuesen Speciale të BE-së, GIZ Kosova dhe KOSID (pjesë e të cilit është INDEP).

Në këtë javë, kishte 5 konferenca ditore, 1 ngjarje anësore, 14 panele, më shumë se 85 folës, 7 shfaqje filmash dhe më shumë se 10 paraqitje mediatike.

Organizatorët zgjodhën të elaborojnë temat. Gjatë kësaj jave, organizatorët zgjodhën të elaborojnë temat si:

- Uji është jetë, Krimet mjedisore.
- Menaxhimi i mbeturinave dhe sfidat në këtë sektor
- Tranzicioni i energjisë dhe ndryshimet klimatike.
- Etj.

Duke pasur parasysh suksesin e jashtëzakonshëm të kësaj ngjarjeje, ngjarja tashmë është vendosur të bëhet një organizim i përvitshëm.

## Qendra Burimore për OShC

Këtë vit kemi filluar nxitjen e Zhvillimit të Qëndrueshëm Organizativ të OSHC-ve në Kosovë së bashku me Forumin për Iniciativa Qytetare (FIQ). Ne synojmë të kontribuojë drejt një shoqërie demokratike përmes zhvillimit të organizatave të qëndrueshme të shoqërisë civile, të cilat do të shërbejnë në ndryshimin autentik për hartimin e politikave dhe marrjen e vendimeve në të gjitha nivelet.

Ky projekt synon të sigurojë zhvillimin organizativ, avokimin, ngritjen e kapaciteteve për mbledhjen e fondeve, profilizimin, ndërtimin e partneriteteve dhe rrjetëzimin OSHC-ve në Kosovë.

Tre komponentët kryesorë të këtij projekti janë:

### Qendra e Resurseve (RC)

Qendra e Burimeve shërben si burim primar i informatave për OSHC-të në Kosovë në lidhje me zhvillimet që janë relevante për sektorin e shoqërisë civile. Është gjithashtu burim i mundësive të gjëra për zhvillimin organizativ dhe ngritjen e kapaciteteve. Qendra e Burimeve është themeluar në hapësirat e Forumit për Iniciativa Qytetare (FIQ) në Prishtinë. Kjo hapësirë është në dispozicion të plotë të të gjitha OSHC-ve në Kosovë dhe i ofrohet atyre për realizimin e aktiviteteve të tyre të ndryshme pa pasur implikime buxhetore për shfrytëzimin e kësaj hapësire.

### Akademia për Qëndrueshmëri

Akademia e Qëndrueshmërisë e cila realizohet në kuadër të

këtij projekti do të sigurojë trajnim gjithëpërfshirës për ngritjen e kapaciteteve të OSHC-ve vendore, jo vetëm në lidhje me zhvillimin organizativ, por edhe në mënyrë specifike për pajisjen e tyre me aftësitë dhe kompetencat e kërkuara për zhvillimin dhe zbatimin e iniciativave të suksesshme të avokimit.

### Grante për OSHC-të pjesëmarrëse

Pjesë e projektit është edhe skema e ndarjes së granteve për 15 organizata lokale, të cilat janë duke u financuar me grante të vogla për realizimin e projekteve të ndryshme. Pas zbatimit të projekteve të tyre, OSHC-të përfituese do të krijojnë partneritete mes tyre, në formë të 4 koalicioneve tematike, për t'u angazhuar në nismat lokale të avokimit.

# ZHVI LLI MI I QËN DRU E SHË M



## Promovimi i energjisë së gjelbërt, mbrotjes së mjedisit dhe ekonomisë qarkore

INDEP në bashkëpunim me Balkan Green Foundation kanë filluar këtë vit zbatimin e projektit trevjeçar 'Empower-Engage Build Ownership'. Ne synojmë të mundësojmë sektorin e shoqërisë civile të Kosovës që të përmbushë rolin e saj në mjedisin demokratik duke vepruar si aktor i pavarur, për të monitoruar institucionet publike, rritur përgjegjshmërinë dhe transparencën në zhvillimin e politikave dhe proceset e vendimmarrjes lidhur me shqetësimet e komuniteteve dhe grupeve të shoqërisë civile në fushat e ruajtjes së mjedisit, energjisë së gjelbër dhe ekonomisë qarkore.

Projekti gjithashtu ka për qëllim përmirësimin e aftësive dhe shkëmbimit të informacionit të OShC-ve mbi monitorimin e politikave, avokimit dhe organizimit të kampanjave. Po

ashtu, fokus i veçantë është vënë në përmirësimin e pjesëmarrjes së OShC-ve në bërjen dhe implementimin e politikave, si dhe rritjen e vetëdijes së qytetarëve për zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë.

Si pjesë e këtij projekti në këtë vit të parë është lansuar edhe skema e granteve, ku si rezultat kemi 16 përfitues të granteve të vogla dhe 3 përfitues të granteve të mesme. OShC-të përfituese janë duke u angazhuar në aktivitete që promovojnë ruajtjen e mjedisit, ekonominë e gjelbër dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike në tërë Kosovën; dhe njëkohësisht, të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për zhvillimin e qëndrueshëm në Kosovë. Kjo skemë e granteve do të jetë e hapur edhe në dy vitet në vijim.



## Konferenca më e madhe në rajon mbi Tranzicionin e Energjisë

Storje tjetër suksesi gjatë 2018 -tës ishte edhe konferenca e organizuar së bashku me partnerë të ndryshëm lokal e ndërkombëtar mbi Tranzicionin e Energjisë. Kjo konferencë mbledhi rreth 200 pjesëmarrës, të cilët patën mundësi të bisedonin mbi tejkalimin e sfidave dhe pengesave, bashkë me strategjitë e politikave, të cilat do të ndihmonin të ecnim drejt tranzicionit energjetik në Kosovë dhe rajon. Në bazë të diskutimit që u mbajt gjatë kësaj konference, u theksua se i tërë regjioni po bazohet në prodhim të energjisë me anë të lëndëve djegëse dhe se është mjaftë e rëndësishme që agjendat e sektorit të energjisë të prioritetizojnë diversifikimin e burimeve të energjisë të cilat janë të qëndrueshme dhe të përballueshme në aspektin financiar dhe mjedisor. Për më

tepër kjo konferencë ofroi një mundësi të vlefshme për krijimin e rrjeteve dhe krijoi mundësi për bashkëpunim të mëtejshëm ndërmjet palëve të ndryshme të interesit në sektorin e energjisë.

# ZHVI LLI MI I QËN DRU E SHË M

## Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Komunitet e Kosovës

Gjatë vitit 2018, INDEP gjithashtu ka filluar angazhimin për arritjen e caqeve të zhvillimit të qëndrueshëm në Komunitet e Kosovës.

Komunitet në Kosovë kanë përgjegjësi të caktuara me ligj në lidhje me politik bërjes dhe vendimmarrjen në regjionet e tyre. Si të tilla, ato financohen dhe marrin përgjegjësi për zhvillimet kryesore në rajonet e tilla.

Kosova ka miratuar dhe si rezultat është e përkushtuar për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Këto objektiva synohet të arrihen deri në vitin 2030—cak ky i synuar nëpërmjet Agjendës 2030.

INDEP në sajë të këtij projekti do t'i ndihmojë shtatë komuna të Kosovës në hartimin e planeve dhe strategjive rreth zhvillimit të qëndrueshëm. Ky proces do të

përfshijë punë të vazhdueshme me komunitet për të definuar prioritetet e tyre të politik bërjes dhe ato strategjike në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm.

Gjithashtu, gjatë kësaj kohe INDEP do të jetë i angazhuar aktivisht për promovimin publik të këtyre objektivave. Ky promovim ka për synim vetëdijesimin e qytetarëve rreth caqeve të zhvillimit të qëndrueshëm në sajë të Agjendës 2030.

INDEP mbetet i përkushtuar për të punuar me të gjithë aktorët vendorë dhe rajonal për të arritur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në vend, dhe më gjerë.



**Goal 1:** End poverty in all its forms everywhere  
**Goal 2:** End hunger, achieve food security and improved nutrition and promote sustainable agriculture  
**Goal 3:** Ensure healthy lives and promote well-being for all at all ages  
**Goal 4:** Ensure inclusive and quality education for all and promote lifelong learning  
**Goal 5:** Achieve gender equality and empower all women and girls



**Goal 6:** Ensure access to water and sanitation for all  
**Goal 7:** Ensure access to affordable, reliable, sustainable and modern energy for all  
**Goal 8:** Promote inclusive and sustainable economic growth, employment and decent work for all  
**Goal 9:** Build resilient infrastructure, promote sustainable industrialization and foster innovation  
**Goal 10:** Reduce inequality within and among countries



**Goal 11:** Make cities inclusive, safe, resilient and sustainable  
**Goal 12:** Ensure sustainable consumption and production patterns  
**Goal 13:** Take urgent action to combat climate change and its impacts  
**Goal 14:** Conserve and sustainably use the oceans, seas and marine resources  
**Goal 15:** Sustainably manage forests, combat desertification, halt and reverse land degradation, halt biodiversity loss



**Goal 16:** Promote just, peaceful and inclusive societies  
**Goal 17:** Revitalize the global partnership for sustainable development





# BASH KË PUNIMI RA JO NAL



Nën programin e bashkëpunimit rajonal, vazhduam t'i shtyjmë para synimet tona dhe partnerëve tanë drejt çështjeve të zhvillimit të qëndrueshëm, qeverisjes demokratike dhe integriteteve Euro-atlantike të vendeve të Evropës Juglindore. INDEP arriti që me sukses, jo vetëm të forcojë bashkëpunimet me partnerët ekzistues, por edhe të integrohet në rrjetëzime të numërta të cilat sollën partneritete të reja për organizatën.

Konferenca e lartpërmendur mbledhi akter të ndryshëm, si ata institucional, përfaqësues të bizneseve dhe organizatave joqeveritare të të gjithë vendeve nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Gjatë kësaj konference, u diskutua se si bashkë me strukturat e tregut të energjisë dhe sistemeve energjetike, edhe legjislacioni në fushën e konkurrencës së tregut, ndihmës shtetërore dhe mekanizmave mbikëqyrës po pëson një transformim të plotë. Për më tepër, u debatua se si një treg i liberalizuar

i tregut të energjisë do të sigurojë mekanizma me anë të së cilëve sigurohet se shteti nuk po favorizon ndërmarrje të caktuara dhe se tregu është konkurrent dhe mbron të drejtat e konsumatorëve.

Në këtë drejtim, INDEP vazhdon të promovojë mbrojtjen e konkurrencës dhe respektimin e legjislacionit evropian në fushën e mbrojtjes shtetërore.

E kur jemi tek sektori i energjisë, këtë vit INDEP organizoi në partneritet me rrjetin SE3T.net, konferencën me temë "Baza Ligjore për Konkurrencë në Sektorin e Energjisë" e mbajtur në dhjetor në Vjenë. Kjo konferencë diskutoi sistemet energjetike në Evropën Juglindore të cilat duhet të jenë të pastra, sigurta dhe të përballueshme në aspektin e kostove. Përveç kësaj, në këtë konferencë u fol mbi kërkesat, sfidat dhe politikat potenciale në mënyrë që kjo pjesë e Evropës të gëzojë një sistem energjetik stabil.

Gjatë vitit 2018, si partner zyrtar i

Forumit Ekonomik Botëror, drejtori ekzekutiv i INDEP-it u ftua si panelistë në diskutimin mbi "Transformimi Digjital i Qyteteve – Si t'i bëjmë ato akoma më të "mençura"?", krahas përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë të Polonisë, dhe këshillave të qyteteve brenda këtij shteti. Forumi Ekonomik përbën një platformë unike për shkëmbimin e pikëpamjeve dhe shërben si vendtakim i liderëve lokalë dhe elitave rajonale prej Evropës Qendrore dhe Lindore me mjedisin biznesor dhe shkencor në mënyrë që të shkëmbehen përvojat dhe të krijohen partneritete. Ky forum është vendtakim i kryeministrave, sekretarëve të shtetit, ministrave e deputetëve të vendeve pjesëmarrëse, pjesëmarrja e të cilëve edhe më tutje vazhdon ta dëshmojë rëndësinë e këtij forumi. Ky forum përbën konferencën më të madhe në Evropën Qendrore dhe Lindore. Në çdo fillim shtatori, ky

forum mbledh rreth 3000 pjesëmarrës dhe mbi 500 gazetarë që ndjekin ngjarjen.

Në 2018, INDEP dhe Kosova ishin për herë të parë pjesëmarrës në Javën Botërore të Energjisë, e cila u mbajt në Milano të Italisë. INDEP u përfaqësua nga hulumtuesja e lartë dhe menaxherja e operacioneve, e cila i është bashkangjitur këtë vit programit të Liderëve të ardhshëm në sektorin e energjisë (Future Energy Leaders FEL – 100) të Këshillit Botëror të Energjisë (ËEC). Me pjesëmarrjen e INDEP në këtë ngjarje sigurohet një përfaqësim botëror i Kosovës në sektorin e energjisë në vitet në vijim. Gjatë 4 ditëve u organizuan punëtori dhe panele të ndryshme në të cilat pjesëmarrësit kanë pas rastin që të njoftohen në mes tjerash edhe me zhvillimet në sektorin e energjisë në Kosovë. Në vazhdë të angazhimit në kuadër të programit të Liderëve të ardhshëm në sektorin e

energjisë, përfaqësuesja e INDEP është e angazhuar në grupin e punës i cili do të merret me identifikimin global të barrierave dhe mundësive për rritjen e pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme të energjisë (përkatësisht erës dhe diellit) në rrjetet ekzistuese të energjisë elektrike. Projekti synon një diagnostifikim global të problemeve dhe mundësive me të cilat ballafaqohen rajonet e ndryshme anë e mbanë botës për sa i përket kësaj çështjeje.



# MBË SHTE TË SIT

Në 2018, INDEP është mbështetur nga:



**Rockefeller Brothers Fund**  
Philanthropy for an Interdependent World



 Federal Ministry  
Republic of Austria  
Sustainability and Tourism



United Nations  
Educational, Scientific and  
Cultural Organization

